



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË**

Maliq, më 21.04.2023

**INFORMACION PËR VENDIMARRJEN DHE PERFORMACËN E KËSHILLIT TË
BASHKISË MALIQ PËR VITIN 2022**

Të nderuar!

Këshilli i Bashkisë Maliq për vitin 2022 ka pasur një aktivitet të plotë në vendimarrje dhe në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin, kemi mundur të arrijmë disa objektiva madhore në kryerjen e funksioneve duke u mbështetur te ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe legjislacioni sektorial për fusha të ndryshme të vetëqeverisjes vendore.

Duke qenë se Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimarrës, përfaqesues dhe mbikqyrës monitories.

Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit po mundohemi në mënyre të përmbledhur të japim aktivitete kryesore të zhvilluara sipas kategorive.

Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshte:

Gjatë vitit 2022 janë realizuar në total 19 mbledhje të Këshillit, prej tyre të 12 radhës dhe 7 jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë.

Në total janë miratuar 122 vendime prej të cilave 7 të pa konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë. Nga vendimet e pakonfirmuara 5 vendime janë konfirmuar nga prefekti pasi janë rifutur në keshill dhe janë miratuar me ndryshimet perkatese, 2 vendime janë rikonfirmuar nga Këshilli duke u lenë në fuqi dhe vetem 0 vendim nuk është shqyrtuar persëri. Jane realizuar 15 mbledhje komisioni.

Këtë vit janë zhvilluar 8 mbledhje on-line dhe 15 mbledhje me takime fizike në salle.

Duhet theksuar që të gjitha mbledhjet e Këshillit janë zhvilluar në transmetim live nëpërmjet faqes së facebook, çka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të japë dhe mendimet dhe sygjerimet e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 kemi miratuar një plan aktivitetesh të shoqëruar me buxhetin perkates të dedikuar vetëm për Këshillin në mënyre që të realizoheshin aktivitetet e planifikuara me një fond prej 300.000 lekë, I cili është ekzekutuar në masën 85 % Për vitin 2022 objektivi ynë kryesor ishte implementimi i rregulloreve dhe planit të aktiviteteve në praktikë. Në bashkëpunim me këshilltarët, administratën dhe komunitetin kemi arritur zbatimin e planit të aktiviteteve në masën 90 %.

Në procesin e shqyrtimit dhe implementimit të këtyre rregulloreve keshilli është asistuar nga Projekti "Bashki të Forta" I cili do vazhdojë edhe për këtë vit të asistojë për të bërë të mundur

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vazhdon të jetë në funksionim rregjistri fizik I ankesave/kerkesave dhe një rregjister fizik i iniciativave/peticioneve ku rregjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mberitura në drejtim të Këshillit të Bashkisë,

Konkretisht janë depozituar në total kërkesa drejtuar Këshillit Bashkiak. Janë trajtuar në bashkëpunim me Ekzekutivin 13 kërkesa dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruara nga ana e këshilltareve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt vendimeve të propozuara nga e



kzekutivi, ne zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2022 u realizuan dhe u paraqitën në keshill 8 informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të bera nga vetë keshilli. Në lidhje me rolin përfaqësues të këshillit për vitin 2022, eshte synuar qe kornunikimi dhe marrja e mendimeve të komunitetit të realizohet nepërmejt komunikimit kryesisht nepërmjet publikimit dhe marrjes së mendirneve nëpërmjet rrjeteve sociale. Për këtë qëllim faqja e Facebbok-ut e Këshillit Baskiak Maliq e cila ka qenë aktive që në vitin 2020, ka publikuar vazhdimisht aktivitet të këshillit, dhe realizuar transmetimin livestream të mbledhjeve, gjë e cila, tashmë është pjesë e procedurave të zhvillimit të mbledhjeve.

Në faqen FB kanë ardhur shumë mendime dhe sygjerime nga komuniteti. Anëtarët e KB, janë fokusuar gjithashtu edhe në takimet direkte me banorët e Bashksie Maliq dhe percjelljen e mendimeve të tyre në mbledhjet e komisioneve dhe të KB.

Në zbatim te Rregullores së Konsultimeve Publike është realizuar Sondazhi on line për prorititetet e qytetareve per PBA 2023-2025. Konsultimi publik përmes sondazhit on line, solli mendimin e qytetareve pranë KB.

Anketimi online u lane në sistem për një periudhe nga Prill. 2022 ne dt 30 Nentor 2022. U realizua nje town hall, ku morën pjesë 40 persona, nga të cilet 15 meshkuj, 25 femra. Përpara townhall u realizuan takime në lagje dhe takime në Njësitë Administrative. Gjatë konsultimeve pubike për PBA 2023-2025, dolën 10 rekomandime nga të cilat 8 i reflektuan ne buxhetin e vitin 2023.

Në këtë drejtim, edhe gjatë vitit 2023, do të vijojë nje bashkëpunim edhe më i mirë me administratën dhe një angazhim më i madh për Ekzekutivin, për përgatitjen në kohë të raporteve dhe informacioneve e planifikuara në planin e aktiviteteve të këshillit por edhe rast pas rasti, sipas kërkesës së KB.

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar secilin për koutributin dhe angazhimin, si dhe duke falenderuar projektin "Bashki të Forta", për bashkëpunimin dhe asistencen për aktivitetin e Këshillit të Bashksië Maliq , ju ftojme të bëheni pjesë, për përmirësimin e punës së këshillit nëpërmjet mendimeve dhe sugjerimeve tuaja.

Faleminderit!